



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:150660

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05634424

CAP.nr.1394/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen përmbartimore të të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, Rr. “Armend Daci”, nr. 1, kundër debitorit A.A, nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.56/2023, i datës 18.08.2023 me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit A.A, nga fshati ..., Komuna e Gjilanit,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.56/2023, i datës 18.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Gjilan me aktvendimin, CPK.nr.56/2023, i datës 18.08.2023, ka vendosur si në vijim:

“Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i datës 22.06.2023, i debitorit A.A, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.274/23 të datës 14.06.2023, të Përmbartuesit Privat S.A, nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve së dispozitave procedurale përmbartimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovojë në tërësi ankesën e debitorit, ashtu që ta ndryshoj aktvendimin e Gjykatës Themelore dhe ta aprovoj prapësimin e debitorit, apo që ta

anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështja ti kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka parashtruar kreditori me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet e pa bazuar ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 14.06.2023, ka paraqitur te përmbartuesi privat propozim për përmbartim kundër debitorit me të cilin ka kërkuar që i njëjti t'ia paguajë kreditorit shumën e përgjithshme prej 5,037.50 euro i krijuar nga shqiptimi i gjobës.

Organi përmbartues, me urdhrin përmbartues P.nr.274/23, i datës 14.06.2023 ka lejuar përmbartimin.

Debitori në afat ligjor ka ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Gjilan kundër urdhrin për përmbartim me propozim që gjykata të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj në tërësi si të pabazuar urdhrin.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin CPK.nr.56/2023, i datës 18.08.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin duke lënë në fuqi urdhrin për përmbartim.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palëve, vërtetoi se prapësimi i debitorit është i pabazuar, pasi që me këtë prapësim nuk ka vërtetuar asnjërën nga shkaqet të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së lidhur me bazueshmërinë e prapësimin dhe se vendimi administrativ me të cilin është iniciuar kjo procedurë është i ekzekutueshëm që nga data 07.11.2022 sipas vulës së ekzekutueshmërisë dhe paraqet titull përmbartimor–dokument përmbartimor, sipas nenit 22, par 1. Pika 1.2 të LPP-ës “Dokumenti përmbartues 1. Dokumente përmbartuese janë: 1.1. vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese; 1.2. vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia),” lidhur me nenin 24 të këtij ligji. Kurse, lidhur me kërkesën për caktimin e seancës, gjykata nuk e sheh të arsyeshme caktimin e një seance të tillë, për shkaqet që u ceken me lartë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Në ankesën e parashtruar debitori pretendon se konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me të cilin është lejuar përmbarimi është i pa bazuar për faktin se urdhri përmbarimor është lëshuar në bazë të një vendimi i cili është marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe kjo për arsyet të cilat debitori i ka sqaruar edhe për gjykatën e shkallës së parë, mirëpo e njëjta nuk i ka shqyrtuar të njëjtat në vendimin kontestues. Në ankesë debitori e konteston në tërësi vendimin në bazë të te cilit është lejuar përmbarimi, ashtu që lëshohet në ligjshmërinë e tij duke pretenduar se ky vendim është i pa qëndrueshëm. Po ashtu, thekson se lidhur me këtë situatë kreditori ka paraqitur edhe kallëzim penal ndaj debitorit, mirëpo çështja penale hetimore është mbyllur nga ana e zyrtarëve policor sipas numrit të rastit CA22-286, i datës 23.08.2022.

Gjykata ankimore gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të lartcekura të debitorit, erdhi në përfundim se të njëjtat janë të pa bazuara për këto arsye:

Fillimisht Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit për faktin se propozimi për përmbarim është bërë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, dhe atë ky propozim është bërë në bazë të dokumentit përmbarues –vendimit përmbarues i dhënë në procedurë administrative, i cili është përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par. 1.2 të LPP-së.

Vendimi në bazë të së cilit është bërë propozimi për përmbarim është në përputhje edhe me nenin 23 të LPP-së, i cili në mënyrë të qartë e përcakton se çka konsiderohet vendim i organit administrativ, ku sipas këtij ligji vendim administrativ konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurën administrative nga organi ose shërbimi administrativ, ku në rastin konkret vendimi është marrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale i cili konsiderohet si organ administrativ i cili ushtron kompetencat në përputhje me ligjin.

Gjykata e Apelit gjatë shikimit të shkresave të lëndës vëren se propozimit për përmbarim i është bashkëngjitur edhe vendimi i kreditorit i cili është në tërësi në përputhje me nenin 36 të LPP-së dhe se i njëjti e përmban klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri.

Duke qenë se kjo Gjykatë nuk gjeti asnjë arsye që vendimin e gjykatës së shkallës së parë ta konsideroj si jo të drejtë dhe jo të ligjshëm të njëjtin e përkrah në tërësi andaj edhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket pretendimeve të debitorit, ku e konteston në tërësi ligjshmërinë e vendimit të organit administrativ në këtë rast të kreditorit, për këtë Gjykatë të njëjtat rezultojnë të mos kenë ndikim në këtë çështje përmbarimore për faktin se në procedurën përmbarimore gjykata kujdeset ekskluzivisht vetëm në kontekstin se a është dokumenti i përshtatshëm për përmbarim, ndërsa ligjshmërinë e dokumentit nuk e vlerëson për shkak se këtë palët mund ta bëjnë në procedura tjera përkatëse nëse kontestojnë ligjshmërinë e vendimit.

Gjykata ankimore vlerëson se nuk ekziston asnjë pengesë e vetme që të mos lejohet ekzekutueshmëria e vendimit të organit administrativ në këtë rast kreditorit, e aq më tepër kur debitori me asnjë fakt nuk e ka provuar të kundërtën, andaj edhe vendosi që ankesën e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa vendimin e Gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj duke e pranuar në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1394/2023, me datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.